

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-181/2015**

**Prishtinë,  
13 dhjetor 2017**

Në çështjen juridike të:

**Ž. D.**

**Pala ankuese**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Isa Kelmendi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/244/2014 të datës 18 qershor 2014 (lëna e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numër KPA22997), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 13 dhjetor 2017, mori këtë

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga **Ž. D.**, e regjistruar me numrin **GSK-KPA-A-181/2015**, kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës **KPCC/D/A/244/2014** sa i përket lëndës së regjistruar në **AKP** me numrat **KPA22997** refuzohen si të pabazuara.
2. Vërtetohet vendimi i **KKPK-së/D/A/244/2014** i datës **18 Qershor 2014** sa i përket lëndës së regjistruar në **AKP** me numrin **KPA22997**.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 14 Maj 2007, **Ž. D.** (më tutje: Pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) (më tutje: AKP) në emër të babait të tij **D. D.**, duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr.217/5, tokë kultivuese me sipërfaqe prej 0.78.63 h, e cila ndoshet në vendin e “utrina” në zonën kadastrale **Softaj/Softović Komuna e Ferizaj/Uroševac** (më tutje: pronat e kërkuara). Ai deklaroi se familja e tij i kishte fituar pronësinë mbi pronat e kërkuara përmes Aktgjykimit për denacionalizim. Humbja e posedimit ishte si rezultat i rrethanave të periudhës 1998/1999 në Kosovë.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese në **AKP** i dorëzoi dokumentet në vijim:
  - Kopje e listës poseduese nr.179 lëshuar nga sherbimi i kadastrit i komunës së Ferizajt i dislokuar në Serbi. Data e lëshimit 30 Shtator 2002 dhe dëshmon se prona e kërkuar ishte e regjistruar si ashkëpronësi  $\frac{1}{2}$  e pjesës ideale e ngastrës 217/5 në emër të babait të palës ankuese **D.D.** dhe axhës së tij **Ć. D.**
  - Letërnjoftim i palës ankuese i lëshuar me 29 Shtator 1980 me adresë vendbanimi **Softaj Ferizaj**.
  - Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj/Uroševac Nr.282/95 i datës 5 Shtator 1995 me të cilin pranohej kërkespadija e **D. D.** dhe **Ć. D.** dhe shkeputej kontrata e faljës së tokës Kooperativës Bujqesore të atëhershme në sipërfaqe prej 2.45.00 h pa specifikuar ngastrat.
  - Procesverbal i Komisionit të kthimit të pronave me të cilin konstatohej se edhe pse është bërë nulimi i kontratës prona nuk mund të kthej e njeta sepse ishte tjetërsuar kurse në vend të kthimit të pronës së njejtë palët u pajtuan që të bëhej kthimi i ngastrës 230 me sipërfaqe prej 0.60.18 h dhe pjesë të ngastrave 217/1 dhe 217/4 në sipërfaqe totale prej 2.17.15 h dhe me këtë kryhej obligimi i kthimit sipas aktgjykimit të vitit 1995.
3. Njoftimi i Kërkesës u bë më 5 tetor 2007 duke i gjetur pronat e kërkuara si tokë e kultivuar dhe të uzurpuara nga persona të panjohur. Më 21 Korrik 2010 u publikua kërkesa në Gazetën e Njoftimeve nr.4 të **AKP-së** dhe në Listën e Zyrës për Prona të UNHCR-së. Gazeta dhe lista u lanë te prijësi i fshatit i cili pranoi që ta lë atë në dispozicion të palëve të

interesuara si dhe në Gjykatën Komunale të Ferizajt, në Zyrën Rajonale të AKP-së në Gjilan. Gjithashtu, Lista dhe Gazeta u shpërndanë në Zyrën Kryesore të UNHCR-së, te Ombudspersoni, të Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK).

4. Sipas detyrës zyrtare AKP-ja kishte gjetur certifikatën e pronësisë ku ngastra kadastrale 217/5 ishte e regjistruar tokë shoqerore e Kombinatit “Milan Zečar” nga Ferizaji. Cerifikata ishte lëshuan me 8 Gusdht 2008.
5. Më 18 qershor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës e hodhi poshtë kërkesën përmes Vendimit të tij KPCC/D/A/244/2014. Në paragrafët 19,23 dhe 82 të Vendimit Grupor, që sipas vendimit të vërtetuar zbatohet veçanërisht për kërkesën në fjalë, thuhet se prona e kërkuar ishte vendosur nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (dhe më pas nën pasardhësen e saj Agjencia Kosovare e Privatizimit) në bazë të aprovimit të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/18 dhe se Kombinati “Milan Zečar” ishte në procesin e likuidimit dhe prandaj prona e kërkuar bie ekskluzivisht nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas nenit 4.1 (c) dhe nenit 5.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut për Dhomën e Posaçme 2008/4. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se bartësi i pretenduar i të drejtës pronësore nuk e ka humbur aftësinë për ta ushtruar të drejtën e tij si rezultat i konfliktit në vitet 1998-1999, por si rezultat i procesit pasues të privatizimit. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të komisionit.
6. Poashtu në paragrafin 82 të rsyetimit të vendimit Komisioni konstaton se kompensimi i dëmit bie jashtë Juridiksionit të KKPK-së duke marrë parasyshë që vendimi nuk e paragjykon të drejtën e paraqitësit të kërkesës që të kërkojë zgjidhje para një gjykatë me juridiksion kompetent.
7. Vendimi iu dorëzua palës ankuese më 8 Janar 2014. Ai paraqiti ankesë më 4 Shkurt 2014.

### **Pretendimet e palës ankuese**

8. Pala ankuese deklaroi se vendimi i KKPK-së përmban shkelje thelbësore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale, si dhe vërtetim të gabuar të fakteve.
9. Pala ankuese pretendon se familja e tij i fitoi të drejtat pronësore mbi pronat e kërkuar në vitin 1995 sipas Aktgjykimit nr. Nr.232/95 i datës 5 Shtator 1995. Me aktgjykimin e njëjtë, Ndërmarrja “ishte urdhëruar që t’i kthejë pronat e kërkuara në posedim të familjes së tij. Pala ankuese deklaroi se në regjistrat kadstral prona është e evidentuar si bashkepronësi e babait të tij dhe e axhës dhe kjo nuk është e kontestuar. Arsye e formimit dhe kompetenca e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ( më parë të Mirëbesimit) nuk mund të jenë bazë për refuzimin e kërkesës sipas palës ankuese.

10. Pala ankuese nënvizon se Komisioni veproi në kundërshtim me obligimin e tij ligjor duke mos arritur të përcaktojë se kush e kishte shfrytëzuar pronën e kërkuar para konfliktit 1998/1999. Po ashtu, pala ankuese thekson se nuk kishte palë kundërshtare dhe se se pronësia e familjes së tij nuk ishte kontestuar nga askush.
11. Në bazë të lartcekurave, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta anulojë vendimin e KKKP-së dhe ta kthejë lëndën për rishqyrtim, apo ta vërtetojë të drejtën e ri-posedimit në dobi të palës ankuese.

### **Arsyetimi ligjor**

12. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se ankesa është e pranueshme dhe e afatëshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së. Kjo për arsye se pala ankuese vendimin e Komisionit e ka pranuar më 8 Janar 2015, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 4 Shkurt 2015. Nga kjo mund të konstatohet se ankesën e ka paraqitur në afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se *“ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit”*..

### **Meritat e ankesës**

13. Gjykata Supreme e shqyrtoi Vendimin e ankimuar dhe konstatoi se ankesa është e pabazuar dhe se KKKP-ja ka marrë vendim korrekt kur e hodhi poshtë kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit të saj.
14. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit nr.03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka ta drejtë nga Komisioni në urdhër për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm pronësinë mbi një pronë të paluajtshme private, por edhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.
15. Fillimisht, pala ankuese pretendon se familja e tij fitoi të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar në bazë të Aktgjykimit Nr.282/95 i datës 5 Shtator 1995 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Ferizajt që u bë i formës së prerë më 20 Tetor 1996. Ky aktgjykim ishte verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së.

16. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së *ex officio* e gjeti Çertifikatën për të Drejtat mbi Pronën e Paluajtshme që i pasqyron pronat e kërkuara të regjistruara në emër të ndërmarrjes “Milan Zečar” të Ferizajt.
17. Në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Gazeta Zyrtare nr.6/80), në fuqi në kohën kur është lëshuar Aktgjykimi nr.723/90 (në vitin 1993), e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik (transfer juridik) dhe me trashëgim.
18. Megjithatë, neni 33 i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80), përcakton se në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në regjistraty publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj. Edhe Ligji aktual nr. 03/L-154 Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në nenin 36 pika 1 parasheh se “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmeri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri.
19. Kjo çon në konkludimin se familja e palës ankuese nuk e ka fituar të drejtën pronësore pasi që nuk janë plotësuar kushtet e neneve 20 dhe 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80).
20. Prona e kërkuar ka qenë dhe ende është e regjistruar në emër të ndërmarrjes “Milan Zečar” të Ferizaj, që do të thotë se ka qenë dhe është pronë shoqërore. Në përputhje me nenin 321, paragrafi 1, të LPK-së, nuk ka nevojë të provohen faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e mëhershme.
21. Vërtetimi dhe mbrojtja e të drejtave pronësore mbi pronat shoqërore dhe/ose pronave shtetërore nuk është në juridiksionin e KKPK-së, respektivisht të Kolegjit të Apelit të AKP-së.
22. Në bazë të gjitha pikave të lartcekura, Gjkata Supreme konstaton se KKPK-ja pala ankuese nuk e kishte humbur posedimin mbi pronën e kërkuar për shkak të konfliktit të viteve, por si pasojë e përfshirjes në një proces të privatizimit nga ana e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit-tani të Privatizimit.
23. Poashtu Gjkata gjenë të mbështetur në Ligj edhe refuzimin e KKPK-së për kompensimin e dëmit për mungesë të juridiksionit nga ana e KKPK-së sepse kjo bie jashtë kompetencës së KKPK-së
24. Gjkata Supreme konstaton nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim të mangët të fakteve.
25. Ky aktgjykim nuk paragjykon ndonjë të drejtë pronësore për poseduesit aktual e as që paraqet pengesë për palët për inicim të procedurës pranë organit kompetent apo gjykatës kompetente nëse e gjejnë me interes ligjor.
26. Në bazë të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore**

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky Aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

*Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit*

*Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it*

*Isa Kelmendi, Gjyqtar*

*Bjorn Olof Brutigam, Ushtrues Detyre i Referentit të EULEX-it*